

VENDIM
Nr. 102, datë 15.2.2017

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA DREJTORIA E
PËRGJITHSHME E TATIMEVE TE MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME, TË
PASURISË SË PALUAJTSHME “DEGA E TATIMEVE DELVINË”, ME QËLLIM PAJISJEN
ME NDËRTESE TË SUBJEKTIT “PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË”, PËR DEGËN
VENDORE TË PARTISË SOCIALISTE DELVINË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 22, shkronja “b”, e 22/1, të ligjit nr.8580, datë 17.2.2000, “Për partitë politike”, të ndryshuar, dhe të neneve 8, pika 3, 13 e 16, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të Ministria e Punëve të Brendshme, të pasurisë së paluajtshme me emërtimin “Dega e Tatimeve Delvinë”, sipas formularit që i bashkëlidhet këtij vendimi, me qëllim pajisjen me ndërtesë të subjektit “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për Degën Vendore të Partisë Socialiste Delvinë.

2. Prona e përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në përgjegjësi administrimi të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, që i bashkëlidhet vendimit nr.818, datë 6.12.2006, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

3. Ministri i Punëve të Brendshme të lidhë kontratën e huapërdorjes, sipas Kodit Civil, me subjektin “Partia Socialiste e Shqipërisë”, në përputhje me shkronjën “b”, të nenit 22, të ligjit nr.8580, datë 17.2.2000, të ndryshuar, për periudhën deri sa partia politike plotëson kushtet e parashikuara në këtë nen.

4. Ngarkohen ministri i Punëve të Brendshme, drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Për inventarizimin e pronave të veçanta)

Institucioni i Pushtetit Qendror: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Bashkia Delvinë

Fusha e përdorimit të pronës: Zyra (tatime dhe taksa)

Nr. Rend.	A			B			C			
	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartës	Nr. Pasurisë	Lloji i Pronës	Emri i Pronës Adresa	Sip. Totale e Pronës (m ²)	Nga Sip.Totale: Sa Ndërtesë (m ²)	Funksioni për të cilin përdoret Prona	Institucioni / Enti me përgjegjësi administrative	Institucioni / Enti përdorues Statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (Shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
10			Truall, ndertese	Dega e Tatimeve Delvine,lagja”Sinan Ballaci”	385	110	Administratë	Ministria e Financave,D.P.T,Dega e Tatimeve Delvine	Dega e Tatimeve Delvine	

